

C.nr.202/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE (ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri) gjyqtari Skender Shala, ne çeshtjen juridike te paditesve dhe Kumnova nga Mitrovica, te cilet i perfaqeson nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur, te cilet i perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati nga Mitrovica, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e kontestit 1.250,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt.25.04.2014, bie kete:

AKT GJYKIM

I – APROVOHET kerkespadia e paditesve dhe **VERTETOHET** se paditsit dhe nga Mitrovica, jane pronar I pjeses se parceles katastrale nr. 632, me kultur shtepi, ne siperfaqe prej **0.0.41 ha** dhe oborr ne siperfaqe prej **0.01.94 ha**, ne vendin e quajtur „ I , e ne siperfaqe te pergjithshme prej **0.02.35 ha**, me masat dhe kufijt qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, e cila patundshmeri evidentohet ne emer te dhe sipas çertifikates se pronesise nr. ZK Mitrovice.

II – OBLIGOHET i padituri qe t'ia njoh kete te drejte paditesve dhe t'i lejoje qe paditesit kete paluajtshmeri ta regjistrojne ne emer te tyre, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komonale ne Mitrovica, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesit ne padin e tyre te parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tyre ne seancat e mbajtura ka theksuar se paraardhesi I tyre - babai (- tani e ndjer) ne vitin 1956, ne baze te marveshjes gojore, e ka blere nga paraardhesit gjyshrit e tani te paditurit dhe paluajtshmerine e cekur si ne dispozitiv per cmimin kontraktues prej 40.000 Din te atehershem, te cilin cmim ia ka paguar ne tersi dhe qe nga momenti i shitblerjes I njeiti se bashku me familjen e tij ka hyre ne posedim te prones, ku ne vazhdimesi e ka shfrytezuar pa asnje lloj kufizimi apo pengese, andaj, ka interes juridik qe kjo paluajtshmeri edhe juridikisht te evidentohet ne emerin e tij.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozoje gjykates qe te ia caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuari i paditsit ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen perfundimtare theksoi se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazushmerija e kerkespadise . Andaj, Gjykates I propozoj qe te njejten ta aprovoj si te bazuar .

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.202/2012 te dt.18.03.2014, te paditurit ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, av. nga Mitrovica, i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise te paditesit ne shqyrtimin kryesor dhe ne fjalen perfundimtare Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga keto arsye.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: certifikaten e prones me nr. te lendes 15-950-11820 , ZK Mitrovicëe, ne emer te dhe procesverbalin mbivendshiqimin C.nr.202/12 te dt.26.03.2014, ekspertize e ekspertit I dt. 08.04.2014, beri veshrtim ne skicen e terenit dhe situacionin e terrenit dhe kopia e planit nga I njejt ekspert gjeodet, ndegjoi deshmitaret dhe I qe te dy nga Mitrovica dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga fleta pseduese te cekur me lart, konstatohet se pjesa e parcesle katastrale nr. evidentohen ne emer te paraardhesve te te paditurit dhe .

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te paluajtshmerive nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Kadastrit ne Mitrovicë, ka vertetuar se paluajtshmerija kontestuese bien – gjegjesisht e

proprone pjeses e parcesle te cekur me lart, ne mase dhe kufij te shprehur ne ekspertize dhe ne shkrim dhe ne skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse te kesaj ekspertize dhe te aprovuat si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga procesverbali mbivendeshiqimin I kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstatoi se paluajtshmerija kontestuese eshte e perkufizuar fizikishte ne very me rruge te karakterit dytsor, ne perendim, lindje dhe jug me prone private. Palujtshmerija kufizohet ne anen lindore, veriore dhe perendimore me mur, ndersa, ne jug me murin e shtepise se te paditurit Ne kete paluajtshmeri gjinden objekte te ndertuara dhe ate shtepi verore e ndertimit te vjeter. (sipas ekspertit gjeodet).

Deshmitari [] deklaroi se ai personalisht e din se paraardhesi i tani paditesve-babai I tyre tani I ndjeri [] e ka blere paluajtshmerin nga paraardhesit e tani te paditurit – tani te ndjeret I [] dhe [], ne cilesi te shitesve ne vitin 1956, ne siperfaqe prej rreth 4 ari, me cmim te shitblerjes I cili tani per tani nuk me kujtohet, te cilin cmim blesesit (paraardhesi e tani paditesit) i aka paguar ne teresi shitesve (tani paraardhesve te te paditurit) per tere siperfaqen. Per sa e di une shitblerja eshte bere nepermes marreveshjes gojore. E di se me rastin e blesjes se patundeshmerise ne ate vend ka ekzistuar edhe shtepi perdhese me diku 4 dhoma e ndertuar para shume e shume viteve .e cila edhe sot e kesaj dite ekziston dhe ne te jetojne njeri nga paditesit. E di se prej kur e ka blere patundeshmeria ka qene e perkufizuar-e rrethuar me mur. E di se prej momentit te shitblerjes e deri me sot te njejtit nuk kane pas kurr njeher ndonji problem apo pengese apo kundershkim lidhur me shfrytezimin e kesaj palujtshmerie nga askush. E di se paditesit nuk ka bere ndonji ndryshim. Keto rrethana me jane te njohura sepse kam qene dhe jam ende fqinje me palet paditese.

Deshmitari [] deklaroi se ai deri para 3 viteve kam jetuar ne lagjen ku gjindet tani p[aluajtshmeria e cila objekt I shqyrtimit. Sic kam degjuar nga babai im I ndjere I cili me ka treguar se paluajteshmerin per te cilen behet fjale e di se paraardhesi i tani paditesve-babai I tyre tani I ndjeri [] e ka blere paluajtshmerin nga paraardhesit e tani te paditurit(gjysherit) – tani te ndjeret [] dhe [], ne cilesi te shitesve ne cilin vit nuk me kujtohet, por e di se kjongjarje kishte shum shume me heret para se me lind une ne siperfaqe prej rreth 4 ari, me cmim te shitblerjes I cili tani per tani nuk me kujtohet, te cilin cmim blesesit (paraardhesi e tani paditesit) ia ka paguar ne teresi shitesve (tani paraardhesve te te paditurit) per tere siperfaqen. Per sa I perket menyres se shiotblerjes nuk e di a kane nenshkruar ndonji kontrat me shkrim apo palet jane marre vesh vetem ne baze te marreveshjes gojore. E di se me rastin e blesjes se patundeshmerise ne ate vend ka ekzistuar edhe shtepi shum te vjetra dhe shupa te ndertuara para shume e shume viteve te cilat edhe sot e asaj dite ekzistojne pervec disa shupave te cilat jane rrenuar. E di se prej kur e ka blere patundeshmeria ka qene e perkufizuar-e rrethuar me mur. E di se prej momentit te shitblerjes e deri me sot te njejtit nuk kane pas kurr njeher ndonji problem apo pengese apo kundershkim lidhur me shfrytezimin e kesaj palujtshmerie nga askush. E di se paditesit nuk ka bere ndonji ndryshim. Keto rrethana me jane te njohura sepse kam jetuar deri para 3 viteve ne fqinjesi me palet paditese.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se patundshmerin tani lendore e ka blere paraardhesi perkatsishy ba bai i paditesve, ne baze te marveshjes gojore ne viti 1956, me qmim te shitblerjes prej 40.000 Din te atehershem dhe se qmimin e shiteblerjes, shitesve ia ka paguar ne tersi, te cilin shitesi menjeher i'a ka lene ne disponim dhe shrytezim te lire kete paluajtshmeri blesve – tani paditesve te cilet se bashku me anetaret e familjes se tij e ka shfrytezuar pa pengesa qe nga momenti i shitberjes e tani, e tutje e shfrytezon.

Ne baze te nenit 21 te LMTHPJ eshte percaktuar se: sipas ligjit pronsia fitohet nder te tjera edhe me mbajtje- me parashkrim fitues.

Ne baze te nenit 28. al.2 te te njejtit ligj parashifet kalimi I kohes perj 10 vitesh per mbajtjen e ligjshem dhe me mirebesim.

Ne baze te provave te cekura me larte e duke marre parasysh se kjo paluajtshmeri eshte blere nga paraardhesit- babait te paditsve nga shitesit – parardhesit e tani te paditurit, qysh ne vitin 1956 dhe se qe nga momenti I shiteblerjes te njejtin se pari parardhesi I paditsve e me pas edhe tani paditesit, e kane ne shfrytezim te lire dhe te pa penguar gjere me tani , gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise te kesaj paluajtshmerie nga ana e paditesve dhe ate ne menyre origjinere , me mbajtje duke filluar qe nga viti 1956, e gjere me tani.

Vendimi mbi shpenzimet e procedure kontestimore, bazaohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga te cekurat me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.202/2012, dt.25.04.2014.

Gj y q t a r i,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimit e verteton:

